



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	08.08.2022	viti god year	2
Organ /Rjesia Organ./Jednica Org./Unit	Rr Prot Rr Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRPIH/M	4603/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.606/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2155/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.606/2021 të datës 01.07.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi: _____ në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr. 14-116/01-114680/21 të datës 18.06.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.606/2021e datës 01.07.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.14-116/01-114680/21 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës i datës 18.06.2021.

A r s y e t i m

Ankuesit _____ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Prishtinës, Komisioni Disiplinor përmes Vendimit me Nr. 14-116/01-114680/21 të datës 18.06.2021 i ka shqiptuar masën disiplinore "*Ndalim 20% i pagës për një periudhë prej gjashtë (6) muajve*", ndërsa i njëjti më datë 01.07.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është protokolluar me Nr. Prot:3410/2021, me pretendimet ankimore për rishikimin e vendimit të Komisionit Disiplinor pasi që i njëjti nuk ka ushtruar dhunë ndaj personit B.S.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.07.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës më datë 05.08.2021 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës, faqe 1-15.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.08.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 22.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2155/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.08.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 01.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 01.07.2021 me numër protokolli 3410/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr. 14-116/01-114680/21 të datës 18.06.2021 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.07.2021; Përgjigje në kërkesë të datës 05.08.2021; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.01.2014; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Raportin e inicimit të procedurës disiplinore të datës 20.05.2021; Urdhëresën e Policisë së Kosovës të datës 22.05.2021; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 22.02.2017; Njoftimin e datës 17.08.2021; Aktgjykimin A.nr.2155/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Fletë kthesën e datës 23.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Ndaj ankuesit, i cili në bazë të Aktit të Emërimit të datës 01.01.2014 i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Nëpunës i Shërbimeve Sociale" në Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, më datë 20.05.2021 Shefi i Njesisë për Punë Sociale ka përgatitur raportin e një shkelje të supozuar ndaj ankuesit me arsyetim se: *"...Për shkak të dyshimit të bazuar për shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, gjegjësisht mosrespektimit dhe shkeljeve të parimeve dhe kushteve të sjelljeve profesionale të nëpunësve civil, Ju drejtohem me kërkesë për shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara dhe inicimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtarit të shërbimeve sociale meqenëse: Dyshohet se në cilësinë e menaxherit të rastit ka ushtruar dhunë ndaj të miturës B.S në rastin e zhvillimit të kontaktit personal, bazuar në vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2863/19 të datës 14.05.2021 (dosja dhe)"*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, më datë 18.06.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-116/01-114680/21 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim 20% i pagës për një periudhë prej gjashtë (6) muajve"*.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi me rastin e mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 02.06.2021 pranë Komisionit Disiplinor ka kërkuar falje për at që ka ndodh me arsyetimin se situata ka ndodhur në afekt, po ashtu në bazë të Urdhëresës së Policisë së Kosovës, konfirmohet se ankuesi është ndaluar me datë 20.05.2021 ditën kur ka ndodhur rasti dhe se i njëjti është liruar ne procedurë të rregullt me vazhdimin e procedurave gjyqësore për dyshimin e bazuar të kryerje së veprës penale, andaj mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore **“Ndalim 20% i pagës për një periudhë prej gjashtë (6) muajve”** ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtarët Publik neni 48 paragrafi 3 i cili përcakton se: **“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”**, ndërlidhur me këtë nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafin 1.2 të këtij ligji përcakton se: **“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”** pasi që shkelja e kryer nga ankuesi hynë në kuadër të shkeljeve të rënda siç përcaktohet me nenin 46 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publik, andaj me këtë rast masa e shqiptuar nga Komisionin Disiplinor është shiptuar pajtim edhe me nenin 45, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, në të cilin decidivisht thuhet se: **“1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.606/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.